



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1974, datë 01.06.2012

Për

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Altelecom me nr. 632Prot, datë 7.2.2012, drejtuar Nisatel “Mbi njoftimin e tarifës së re për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në Altelecom.”;
- Shkresa e Nisatel me nr. 303/1Prot, datë 7.2.2012, drejtuar Altelecom “ Mbi njoftimin e tarifës së trafikut ndërkombëtar në rrjetin Nisatel.”;
- Shkresa e Altelecom me nr. 769Prot, datë 14.2.2012, drejtuar Nisatel “ Mbi njoftimin e tarifës së re për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Altelecom.”;
- Shkresa e Altelecom me nr. 632Prot, datë 16.2.2012, drejtuar Nisatel “ Mbi pergjigjen tuaj nr. 303/1 dt 07.2.2012.”;
- Shkresa e Nisatel me nr. 304/3Prot, datë 25.4.2012, drejtuar AKEP “Mbi amendamentin nr. 1 të MI nr. 2929Prot, datë 24.6.2011.”;
- Procesverbali i seancës paraprake dëgjimore mes palëve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a., mbajtur me datë 18.5.2012, ora 11:00, në ambientet në AKEP,
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe,

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Nisatel sh.p.k., me shkresën nr. 404/1Prot., datë 3.5.2012 “*Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Nisatel sh.p.k dhe Altelecom sh.a.*”, sqaron si më poshtë:
 1. Nisatel, pas marrjes së vendimit nga AKEP – Vendim Nr. 1742 datë 20.12.2011 për “Disa ndryshime në VKD Nr. 1348 dt.26.7.2010”- Altelecom ka njoftuar OP Nisatel me shkresën e datës 07.02.2012 “Mbi njoftimin e tarifës së re për terminimin e

- thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Albtelecom” duke njoftura se kjo tarifë nga data 14.2.2012 do të jetë 6.1 lek/min +0.83 lek/thirrje;
2. Nisatel, me shkresën nr. 303/1Prot, datë 7.2.2012 ka njoftuar Albtelecom “Se duke filluar nga data 14.2.2012 tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Nisatel do të jetë 5.0 lekë/min +0.83 lekë/thirrje.”;
 3. Albtelecom, me shkresën nr. 632Prot datë 16.2.2012 pranon se “Mbetet i hapur në cdo kohë për të diskutuar mbi cdo iniciativë të Nisatel për të Proceduar me Amendimin e Marrëveshjes së interkoneksionit.”;
 4. Në datë 12.4.2012 Albtelecom dërgon draft amendamentin e MI pasi ishte realizuar më parë një takim midis palëve ku i propozon Nisatel konkretisht tarifën e terminimit në rrjetin Albtelecom për trafikun ndërkombëtar 6.1 lek/min+0.83 lek/min dhe tarifen e terminimit në rrjetin Nisatel për trafikun dërkombëtar 3.54 lek/min+0.83 lek/thirrje.;
 5. Nisatel, me shkresë nr. 304/3Prot, datë 25.4.2012 dërgon shkresë “Mbi Amendamentin Nr.1” ku arsyeton bazën ligjore dhe refuzon propozimin e tarifës së terminimit në rrjetin Nisatel për thirrjen ndërkombëtare nga Albtelecom me vlerë 3.5 lek/min dhe i qëndron njoftimimeve midis palëve për tarifat e terminimit të cmimit ndërkombëtar në rrjetet respektive dhe spjeron se:
 - a. Nisatel ka ndryshuar tarifën e terminimit në rrjetin e vet për thirrjet ndërkombëtare në 5 lek/min+0.83 lek/thirrje është më se e pranueshme dhe cmimi prej 3.5 lek/min që Albtelecom propozon është abuzive me pozitën dominuese në treg.
 - b. Kjo tarif hyn në fuqi që nga data 14.2.2012, sipas njoftimit të Nisatel.
 6. Nëse Albtelecom kërkon të shfrytëzoj pozitën e tij dominuese në tregun ndërkombëtar , si një treg tashmë jo nën rregullim, mund ta bëj atë duke ngritur tarifën e terminimit të thirrjeve nderkombëtare drejt operatorëve alternativ (në këtë rast për Nisatel) dhe jo duke zhvatur operatorët e tjerë kombëtar.
 7. Në përfundim Nisatel sh.p.k., kërkon nga Këshilli Drejtues i AKEP:
 - a. Përcaktimin e tarifës së terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin Nisatel nga Albtelecom.
 - b. Datën e hyrjes në fuqi të kësaj tarife.
 - c. Nënshkrimin e një amendamenti me këto terma.
 8. Më datë 19.5.2012, në mbientet e AKEP, me palët Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a., u zhvillua takimi konsultativ paraprak, me qëllim degjimin e palëve për çështjen objekt i mosmarrëveshjes. Edhe gjatë këtij takimi palët mbajtën të njëjtat qëndrime duke mos rënë dakord. Nga AKEP u la nje afat prej shtatë ditësh per te njoftuar për ndonjë zhvillim në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Brenda ketij afati, nga palët nuk u njoftua në AKEP.
- II. Sa më sipër, duke qënë se, sipërmarrësit Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a, megjithë përpjekjet e bëra edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr.

9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Dritan Malaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE